

LIGJ
Nr. 47/2020

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR NJË HUA SHITESË NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT TË KUVAJTIT PËR ZHVILLIMIN
EKONOMIK ARAB PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË REHABILITIMIT TË
RRUGËS SË LUMIT TË VLORËS**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja për një hua shtesë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab për financimin e projektit të rehabilitimit të rrugës së Lumit të Vlorës, në shumën prej 6 800 000 (gjashtë milionë e tetëqind mijë) dinarësh kuvajtianë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.4.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11474, datë 30.4.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Ilir Meta

ORIGINALI: ARABISHT

NUMRI I HUAS: 1027

MARRËVESHJE PËR HUA SHITESË
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË REHABILITIMIT TË RRUGËS SË LUMIT TË
VLORËS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT TË KUVAJTIT
PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB

DATË 2.3.2020

MARRËVESHJE PËR HUA SHITESË PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË
REHABILITIMIT TË RRUGËS SË LUMIT TË VLORËS

Kjo marrëveshje, e lidhur në datën 2.3.2020, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (referuar në vijim si “Huamarrësi”) dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab (referuar në vijim si “Fondi”),

duke pasur parasysh se nëpërmjet Marrëveshjes së Huas nr. 943, datë 30.3.2016, ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit, Fondi ka rënë dakord t’i jepte Huamarrësit një hua në vlerën

dymbëdhjetë milionë dinarë kuvajtianë (12,000,000/- KD) për të mundësuar financimin e Projektit të Rehabilitimit të Rrugës së Lumit të Vlorës (referuar në vijim si “Projekti”);

duke pasur parasysh se Huamarrësi ka kërkuar një hua shtesë nga Fondi, me qëllim që të mbulohen kostot e shtuara të Projektit;

duke pasur parasysh se Huamarrësi ka marrë përsipër që të sigurojë shumat e mëtejshme nga burime financiare të veta ose të jashtme, në monedhë të huaj dhe vendëse, sipas nevojës për mbulimin e kostos së projektit;

duke pasur parasysh se roli i Fondit është të ndihmojë vendet arabe dhe vende të tjera në zhvillim për të zhvilluar ekonominë e tyre, si dhe t’u mundësojë këtyre vendeve hua për zbatimin e projekteve dhe të programeve përkatëse të zhvillimit;

duke pasur parasysh se Fondi është i bindur për rëndësinë dhe përfitimet e projektit për të kontribuar në zhvillimin e ekonomisë së Huamarrësit; dhe

duke pasur parasysh se sa më sipër, Fondi ka rënë dakord që t’i japë Huamarrësit një hua, referuar në vijim si “Huaja shtesë”, sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në këtë Marrëveshje,

si rrjedhojë, palët bien dakord si më poshtë:

Neni I Përkufizime

Seksioni 1.01. 1) Përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje apo nëse konteksti e kërkon ndryshe, fjalët dhe frazat e përdorura në këtë Marrëveshje kanë të njëjtat kuptime me ato në Marrëveshjen e Huas të lidhur në datën 30.3.2016 ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit.

Seksioni 1.02. Për sa kohë që nuk kërkohet ndryshe nga konteksti, termat e mëposhtëm, kurdo që përdoren në këtë Marrëveshje, kanë kuptimin përkatës të përcaktuar më poshtë:

1) Termi “Marrëveshja e Huas së Parë” nënkupton Marrëveshjen e Huas nr. 943, të lidhur më 30.3.2016 ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit.

2) Termi “Hua e Parë” nënkupton huan, sipas Marrëveshjes së Huas së Parë.

3) Termi “Hua Shtesë” nënkupton huan që do të jepet në përputhje me këtë Marrëveshje.

5) Termi “Hua” nënkupton Huan e Parë dhe Huan Shtesë, të konsoliduara në përputhje me seksionin 2.02 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni II Huaja; interesi dhe detyrime të tjera; shlyerja; vendi i pagesës

Seksioni 2.01. Fondi pranon t’i japë Huamarrësit, bazuar në termat dhe kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje apo referuar në vijim, një shumë prej gjashtë milionë e tetë qind mijë Dinarë Kuvajtianë (6,800,000/- KD).

Seksioni 2.02. Huaja Shtesë, që do të jepet në përputhje me seksionin e mësipërm, do të konsolidohet me të Parën dhe u nënshtrohet termave dhe kushteve të përcaktuar në Marrëveshjen e Huas së Parë, sikur të ishin përcaktuar shprehimisht në këtë Marrëveshje.

Seksioni 2.03. Huamarrësi paguan një normë vjetore interesi prej dy për qind (2.0%) mbi shumën e principalit të Huas të tërhequr dhe të pashlyer herë pas here. Interesi akumulohet nga datat përkatëse të tërheqjes së shumave në fjalë.

Seksioni 2.04. Për të mbuluar shpenzimet administrative dhe shpenzimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, shumave të tërhequra nga Huaja dhe të atyre të papaguara iu ngarkohet një detyrim shtesë prej gjysmë për qind (1/2 e 1%) në vit.

Seksioni 2.05. Në rast se Fondi, në përputhje me seksionin 3.02 të Marrëveshjes së Huas së Parë, ndërmerr një angazhim të veçantë të pakthyesëm me kërkesë të Huamarrësit, Huamarrësi paguan një tarifë për këtë angazhim të veçantë me normë vjetore prej gjysmë për qindësh (1/2 e 1%) mbi shumën e pashlyer herë pas here të principalit të angazhimeve të veçanta në fjalë.

Seksioni 2.06. Interesi dhe detyrimet e tjera llogariten në bazë të një viti 360-ditor me dymbëdhjetë muaj 30-ditorë, për çdo periudhë më të shkurtër se gjysma e plotë e një viti.

Seksioni 2.07. Huamarrësi pagan shumën e pashlyer të principalit të Huas së Parë dhe të Huas Shtesë, të konsoliduara në përputhje me seksionin 2.02 të kësaj Marrëveshjeje, sipas skedulit të amortizimit të përcaktuar në aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 2.08. Interesat dhe detyrimet e tjera paguhën çdo gjashtë muaj në datën 1 shkurt dhe 1 gusht të secilit vit.

Seksioni 2.09. Principali i Huas, si dhe interesat dhe detyrimet e tjerë mbi të, paguhën në Kuvajt ose në cilindo vend tjetër që Fondi mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme.

Neni III

Tërheqja e të ardhurave të huas

Seksioni 3.01. a) Huamarrësi, nëpërmjet Fondit shqiptar të Zhvillimit, do të përdorë të ardhurat e Huas Shtesë për të mbuluar kostot e arsyeshme të mallrave, të nevojshme për zbatimin e projektit të përcaktuar në aneksin 2 të kësaj Marrëveshjeje. Mallrat e posaçme që do të financohen dhe procedurat për prokurimin përcaktohen në aneksin 2 dhe aneksin 3 dhe në dokumentin bashkëlidhur këtij të fundit që mund të ndryshohet në të ardhmen me një marrëveshje tjetër ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit, në përputhje me nevojat e Projektit.

b) E drejta e Huamarrësit për të kryer tërheqje nga Huaja përfundon më 31.12.2023 ose në një datë tjetër që mund të bihet dakord herë pas here ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit.

Neni IV

Objekti i zbatimit të marrëveshjes së huas së parë dhe asaj shtesë

Seksioni 4.01. Marrëveshja e Huas së Parë do të vijojë të jetë e vlefshme dhe në fuqi. Dispozitat e Marrëveshjes së Huas së Parë rregullojnë Huan Shtesë, sikur dispozitat në fjalë të ishin përcaktuar shprehimisht në këtë Marrëveshje. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, do të kenë përparësi dispozitat e Marrëveshjes së Huas Shtesë.

Neni V

Hyrja në fuqi

Seksioni 5.01. Kjo Marrëveshje nuk hyn në fuqi derisa Fondit t'i jenë paraqitur dëshmi të mjaftueshme se ekzekutimi dhe dorëzimi i kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit të jenë autorizuar ose ratifikuar, sipas rregullave nga të gjitha veprimet e nevojshme qeveritare.

Seksioni 5.02. Si pjesë e dëshmive që duhet të mundësohen në përputhje me pikën 5.01 të këtushme, Huamarrësi i paraqet Fondit opinionin ose opinionet e autoritetit kompetent që kjo Marrëveshje është autorizuar ose ratifikuar në mënyrën e duhur dhe është ekzekutuar dhe përmbushur në emër të Huamarrësit, dhe përbën detyrim të vlefshëm dhe të zbatueshëm për Huamarrësin në përputhje me kushtet e saj.

Neni VI

Adresat

Adresat e mëposhtme përcaktohen për qëllime të pikës 7.01 të Marrëveshjes së Huas së Parë:

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmoret e Kombit”, nr. 3
Tiranë, Shqipëri

Adresa alternative kabllore dhe telekset:

Email:
sekretariamin@financa.gov.al

Për Fondin:

Fondi i Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab
Kutia Postare 2921, Safat
Kuvajt - 13030

Adresa alternative:

Email, faks:
operations@kuwait-fund.org (965) 22999190

Në dëshmi sa më sipër, palët e kësaj Marrëveshjeje, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë nënshkruar përkatësisht këtë Marrëveshje dhe e kanë dorëzuar atë në Tiranë, në dy kopje origjinale të barasvlershme, në datën dhe në vitin e shkruar në fillim të kësaj Marrëveshjeje.

Fondi i Kuvajtit për Republikën e Shqipërisë
Zhvillimin Ekonomik Arab

Nga: _ Firma
(Përfaqësuesi i autorizuar)

Nga: _ Firma
(Përfaqësuesi i autorizuar)

ANEKSI 1:
SKEDULI I AMORTIZIMIT

SI. nr.	Pagesa e principalit (shprehur në dinar kuvajtian)
1	495,000
2	495,000
3	495,000
4	495,000
5	495,000
6	495,000
7	495,000
8	495,000
9	495,000
19	495,000
11	495,000
12	495,000

13	495,000
14	495,000
15	495,000
16	495,000
17	495,000
18	495,000
19	495,000
20	495,000
21	495,000
22	495,000
23	495,000
24	495,000
25	495,000
26	495,000
27	495,000
28	495,000
29	495,000
30	495,000
31	495,000
32	495,000
33	495,000
34	495,000
35	495,000
36	495,000
37	495,000
38	485,000
TOTAL	18,800,000
I	

ANEKSI 2 PËRSHKRIMI I PROJEKTTT

Projekti do të kontribuojë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Rajonit të Vlorës nëpërmjet përmirësimit të shërbimit të transportit të pasagjerëve dhe të mallrave, gjë që do të reduktojë kohën e udhëtimit dhe do të minimizojë kostot e transportit, krahas përmirësimit të sigorisë së qarkullimit rrugor.

Projekti parashikon punimet civile për shtrimin e 74 km rrugë ekzistuese në aksin Vlorë–Peshkëpi–Qeparo dhe zgjerimin e saj me dy karrexhata me gjerësi 3,75 m dhe bankina 0,75 m në secilin krah. Projekti parashikon, gjithashtu, punimet për rehabilitimin e infrastrukturës së kullimit, objekteve të sigorisë dhe ndriçimit, krahas trotuareve në qytezat kryesore përgjatë rrugës, si dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme të konsulencës për projektimin, dokumentet e tenderimit të projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve.

Projekti përfshin elementet kryesore të mëposhtme:

1. Punimet tokësore dhe shtresat e shtrimit të rrugës.
 2. Rehabilitimin e strukturave të kullimit, masave të sigorisë dhe ndriçimit, duke përfshirë dhe punime të ndryshme.
 3. Shërbimet e konsulencës inxhinierike.
- Projekti ndahet në tri lote si më poshtë:
- Loti 1: Vlorë–Gjorm, me gjatësi përafërsisht 23 kilometra.
 - Loti 2: Gjorm–Ura e Lasko s me gjatësi përafërsisht 24 kilometra.
 - Loti 3: Ura e Lasko–Qeparo, me gjatësi përafërsisht 27 kilometra.

Projekti pritet të përfundojë në fund të vitit 2022.

ANEKSI 3
LISTA E MALLRAVE QË DO TË FINANCOHEN NGA HUAT

Referuar Marrëveshjes ndërmjet nesh, e cila mban të njëjtën datë, për një Hua Shtesë për të financuar Projektin e Rehabilitimit të Rrugës së Lumit të Vlorës, kemi bashkëngjitur listën e mallrave, ku përfshihen zërat që do të financohen nga të ardhurat e Huas Shtesë, dhe përqindja e shpenzimeve për secilin nga zërat që do të financohet.

Lidhur me listën e mallrave në fjalë, konfirmojmë që përmbajtja e aneksit nr. 3 dhe 4, të nënshkruar nga ne njëkohësisht me Marrëveshjen e Huas nr. 943, datë 30.3.2016, mbetet e pandryshuar dhe zbatohet në lidhje me përdorimin e të ardhurave të Huas Shtesë të lartpërmendur, në përputhje me dispozitat e nenit III të kësaj Marrëveshjeje dhe lidhur me çdo kontratë të financuar nga të ardhurat në fjalë.

LISTA E MALLRAVE QË DO TË FINANCOHEN NGA HUAJA

Nr. i zërit	Zërat	Shpërndarja e të ardhurave (shprehur në dinar kuvajtian)	Përqindja e shpenzimeve
1. Punimet e ndërtimit		18,023,000	77%
2. Shërbimet e konsulencës		777,000	100%
TOTALI		18,800,000	